

Koment i Umdeh el Ahkam - 1

Ijkadhu el Ef'hem fi Sherhi Umdeh el Ahkam

Shejh Sulejman bin Muhamed

Përktheu Xhabir SHEME

{Mësimi i parë}

Hadithi nr.1

عَنْ أَبِي عَمْرٍو الشَّيْبَانِيِّ وَأَسْمُهُ سَعْدُ بْنُ إِيَاسٍ - قَالَ : حَدَّثَنِي صَاحِبُ هَذِهِ الدَّارِ - وَأَشَارَ بِيَدِهِ إِلَى دَارِ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ مَسْعُودٍ قَالَ : ((سَأَلْتُ النَّبِيَّ : أَيُّ الْعَمَلِ أَحَبُّ إِلَى اللَّهِ ؟ قَالَ : الصَّلَاةُ عَلَى وَفْتِهَا . قُلْتُ : ثُمَّ أَيُّ ؟ قَالَ : بِرُّ الْوَالِدَيْنِ , قُلْتُ : ثُمَّ أَيُّ ؟ قَالَ : الْجِهَادُ فِي سَبِيلِ اللَّهِ , قَالَ : حَدَّثَنِي بِهِنَّ رَسُولُ اللَّهِ وَلَوْ اسْتَزِدُّنَهُ لَزَادَنِي))

Transmetohet nga Amër esh Shejbani, emri i të cilit është Sead bin Ijas, se ai ka thënë: "Më ka treguar i zoti i kësaj shtëpie, dhe bëri me shenjë nga shtëpia e Abdullah bin Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!): 'Pyeta të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

- Cila është vepra më e mirë?
- Namazi në kohën e tij, - tha ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)
- Po pastaj cila?
- Respektimi i prindërve.
- Po pastaj cila?
- Xhahadi në Rrugë të Allahut.

Thotë (Ibn Mes'udi): 'Këto m'i ka treguar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe, nëse do t'i kërkoja më tepër, ai do të më tregonte."¹

Transmetuesit e hadithit:

Ebu Amër esh Shejbani Sad bin Ijas, i cili ka arritur kohën kur u shfaq i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), në fillimet e thirrjes së tij, porse nuk e ka pranuar islamin vetëm se pas vdekjes së tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!). Ai ka jetuar 120 vjet.

Abdullah bin Mesud (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), sahabi i ndershëm, njëri prej të parëve që ka pranuar islamin. Ai është prej atyre që kanë mbledhur Kuranin në kohën e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) si dhe një prej të katërve për të cilët

¹ E transmeton Buhariu (527), Muslimi (85), etj.

profeti (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka urdhëruar që të mësohet Kurani prej tyre. Ka vdekur në vitin 36 të hixhrit.

Dobitë e përfutuara nga hadithi:

1. Veprat ndryshojnë nga njëra-tjetra për sa i përket mirësisë dhe shpërblimit dhe se disa prej veprave janë më të mira sesa disa të tjera.

Dijetarët kanë rënë në kundërshtim se cila është vepra më e mirë:

Kanë thënë: Është namazi. Ky është medh'hebi i *xhumhurëve* (shumicës), duke u bazuar në hadithin e mësipërm dhe në hadithe të tjera që tregojnë pozitën e namazit.

Kanë thënë: Është xhahadi -, duke u bazuar në hadithin:

(لغدوة في سبيل الله أو روحة خير من الدنيا وما فيها)

“Shkuarja herët në mëngjes në rrugë të Allahut apo shkuarja në mbrëmje është më e mirë, sesa dynjaja dhe çfarë ka në të.” (Mutefekun alejhi)

Kanë thënë: Është agjërimi -, duke u bazuar në hadithin që e transmeton Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), ku thotë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(الصيام جنة من النار)

“Agjërimi është mburojë që të mbron prej zjarrit.” (E transmeton imam Ahmedi)

Kanë thënë: Është dija -, kjo për shkak të teksteve të shumta që kanë ardhur për mirësinë e dijes dhe dobinë e saj.

Shejh Muhamed bin Uttejmin (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

“E sakta në lidhje me këtë është se veprat ndryshojnë sipas bërësit të saj dhe ndryshimin e kohës. Ne mund t'i themi ndonjë personit se gjëja më e mirë për ty është xhahadi. Tjetrit i themi: 'Më e mira për ty është dija'. Nëse personi është trim, i fortë dhe i shkathhtë dhe nuk është i zgjuar, atëherë gjëja më e mirë për të është xhahadi, ngase kjo i shkon për shtat atij. E, nëse ai është i zgjuar, ka memorie të fortë dhe është i fortë në argumentim, atëherë më e mira për të është dija. Pra, kjo varet sipas bërësit (personit). Ndërsa për sa i përket kohës, nëse jetojmë në një kohë në të cilën është përhapur injoranca dhe bidatet dhe janë shtuar ata që japin fetva pa pasur dije, në këtë rast, dija është më e mirë sesa xhahadi; nëse ne jemi në një kohë ku dijetarët janë të shumtë dhe ka nevojë për

njerëz që të ruajnë vendet islame, në këtë rast, gjëja më e mirë është xihadi. Në rast se nuk është kjo dhe as tjetra, atëherë më e mira është dija.”

2. Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është pyetur në lidhje me veprat më të mira dhe ai u përgjigj me përgjigje të ndryshme. Prej tyre:

- a) Është pyetur (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se cili është islami më i mirë? Tha: “Të ushqesh (të shpërndash ushqim), të përhapësh selamin atij që njeh dhe atij që nuk e njeh.” (Mutefekun alejhi)
- b) Është pyetur (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se cila është puna më e mirë? Tha: “Besimi në Allahun, në të Dërguarin e Tij.” Iu tha: "Po pastaj kush?" Tha: “Lufta në rrugën e Allahut.” Iu tha: "Pastaj kush?" Tha: “Haxhi i pranuar.” (Mutefekun alejhi)
- c) Është pyetur (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se cili është islami më i mirë? Tha: “Është ai, nga gjuha dhe dora e të cilit muslimanët janë të qetë.” (Mutefekun alejhi)

3. Mirësi e faljes së namazit në kohën e tij.

Në një transmetim tjetër, ka ardhur “në fillim të kohës së tij”, porse ai është *daif*.

4. Pëlqimi i nxitimit për faljen e namazit në kohën e parë.

Duke u bazuar në fjalën e Allahut të Madhëruar:

[وسارعوا إلى مغفرة من ربكم . . .]

“Shpejtoni për tek falja e Zotit tuaj...”

Ngase kjo është më e shpejta për heqjen e barrës (përgjegjësisë), përjashto nga kjo namazin e drekës në kohë të nxehtë si dhe namazi i jacisë duke mos pasur vështirësi (në vonimin e tij).

5. Nuk lejohet vonimi i namazit nga koha e tij. Allahu i Madhëruar thotë:

[إن الصلاة كانت على المؤمنين كتاباً موقوتاً]

“Me të vërtetë namazi është detyrë për besimtarët në kohë të përcaktuar.”

Po ashtu i Madhëruari thotë:

[فويل للمصلين الذين هم عن صلاتهم ساهون]

“Mjerë për ata të cilët, kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet.” (Maun 4-5)

Disa dijetarë kanë thënë: "Është për qëllim vonimi i namazit nga koha e tij".

Shejhul islam Ibën Tejmije ka thënë:

“Nuk lejohet vonimi i namazit nga koha e tij, për shkak të xhynubllëkut, as nevojës, as për shkak të papastërtisë etj. Porse personi e fal namazin në kohën e tij sipas mundësisë dhe gjendjes së tij. Nëse ai ka kryer nevojën dhe s’ka ujë për të marrë abdes apo frikësohet dëmit që mund t’i sjellë përdorimi i ujit, ai merr *tejemum* dhe falet. Kjo ngase falja e namazit në kohën e tij është *fard* (detyrë) ... “

6. Mirësia e respektimit të prindërve. Allahu i Madhëruar thotë:

[قل تعالوا أتلوا ما حرم ربكم عليكم ألا تشركوا به شيئاً وبالوالدين إحساناً]

“Thuaju: “Ejani t’ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit.” (El Enam 151)

Sjellja e mirë ndaj tyre (prindërve) ndahet në dy pjesë:

1. Gjatë jetës; sjellja e mirë ndaj tyre me fjalë të mira dhe të buta, me thjeshtësi, duke shpenzuar për ta, duke u shërbyer atyre dhe duke kërkuar kënaqësinë e tyre.
2. Pas vdekjes së tyre; duke u lutur për ta, duke përmbushur porosinë e tyre dhe duke respektuar e nderuar miqtë e tyre.

7. Prej dobive që përfitohen nga ky hadith është edhe: Mirësia e xhihadit në rrugë të Allahut. Duke u bazuar në hadithin që e kemi përmendur më sipër:

(لغدوة في سبيل الله أو روحه خير من الدنيا وما فيها)

“Shkuarja herët në mëngjes në rrugë të Allahut apo shkuarja në mbrëmje është më e mirë, sesa dynjaja dhe çfarë ka në të.” (Mutefekun alejhi)

8. Dijetarët kanë thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ka renditur xhihadin pas respektimit të prindërve, ngase për xhihadin në rrugë të Allahut duhet të marrësh lejen e prindërve [kjo nëse është vullnetar].

9. Pohimi i dashurisë së Allahut të Madhëruar ashtu siç i takon madhërisë dhe Krenarisë së Tij duke mos bërë shtrembërim në të, as shëmbëllim dhe as anulim (teatil). Allahu i Madhëruar thotë:

[إن الله يحب المحسنين]

“Me të vërtete që Allahu i do bamirësit.”

Po ashtu i Madhëruari thotë:

[إن الله يحب المتقين]

“Me të vërtete që Allahu i do të devotshmit.”

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(لأعطين الراية رجلاً يحب الله ورسوله ويحبه الله ورسوله)

“Kam për t’ia dhënë flamurin nesër një personi të cilin e do Allahu dhe i Dërguari i tij dhe ai e do Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”

10. Prej dobive që përfitohen nga ky hadith: Fik’hu i Ibën Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) **ngase ai u përmbajt nga pyetjet drejtuar të Dërguarit të Allahut** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) **në këtë kufi** (që përmendet në hadith). **E kjo prej frikës se mos atij i shtoheshin veprat dhe s’do të kishte mundësi që t’i kryente të gjitha ato apo për shkak të edukatës ndaj të Dërguarit të Allahut** (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), **në mënyrë që ta mos rëndonin atë pyetjet.**

{Mësimi i dytë}

1. Njohja me namazin:

Nga ana gjuhësore: Namaz do të thotë lutje. Prej saj është fjala e Allahut të Madhëruar:

[وصل عليهم إن صلاتك سكن لهم]

“Lutu për ta, sepse lutja jote është vërtet qetësim për ata.” (Et Teube 103)

Nga ana terminologjike: Adhurim i përbërë me fjalë dhe veprime të cilat hapen (fillojnë) me tekbir (me thënien Allahu Ekber) dhe mbyllen (përfundojnë) me dhënien e selamit.

2. Gjykimi për namazin:

Ibën Kudameh ka thënë:

“Ai (namazi) është *vaxhib* me anë të Kuranit, Sunetit dhe konsensusit (*ixhmas*).”

- Argument nga Kurani

Allahu i Madhëruar thotë:

[وما أمروا إلا ليعبدوا الله مخلصين له الدين حنفاء ويقيموا الصلاة ويؤتوا الزكاة وذلك دين القيمة]

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.” (El Bejjine 5)

Po ashtu Allahu i Madhëruar thotë:

[إن الصلاة كانت على المؤمنين كتاباً موقوتاً]

“Me të vërtetë që namazi është detyrë për besimtarët në kohë të përcaktuar.”

- Argument nga Suneti

Transmetohet nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) se ka thënë: I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(بني الإسلام على خمس شهادة أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسول الله ، وإقام الصلاة ، وإيتاء الزكاة ، ...)

“Feja islame është ndërtuar mbi pesë (shtylla): Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit...” (Mutefekun alejhi)

- Argument nga konsensusi

Populli musliman ka rënë në konsensus në lidhje me obligimin e pesë namazeve në ditë-natë.

3. Kur është bërë detyrë namazi

Namazi është bërë detyrë natën e Israsë dhe Miraxhit. Transmetohet nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë në hadithin e Israsë dhe Miraxhit:

- '... Pastaj Allahu më shpalli mua atë që kishte caktuar për të më shpallur dhe bëri obligim për mua pesëdhjetë namaze ditën-natën. Pastaj shkova tek Musai, i cili më pyeti:
- Çfarë bëri Zoti yt detyrë për popullin tënd?
- Pesëdhjetë namaze -, i thashë
- Kthehu te Zoti yt dhe kërkoji të ulë numrin e namazeve, sepse populli yt nuk do të mund ta mbajë këtë përgjegjësi sepse edhe mua mu dha sprovë për bijtë e Israilit, i provova ata dhe i gjeta shumë të dobët të mbanin një barrë të rëndë si kjo -, më tha ai.

U ktheva te zoti im dhe i thashë:

- Zoti im, lehtësoji gjërat për popullin tim!

Zoti më uli pesë nga numri i namazeve. Unë u ktheva te Musai e i thashë:

- Zoti m'i uli pesë namaze për mua.
- Mbase, populli yt nuk do të mundë ta mbajë këtë barrë. Kthehu te Zoti yt dhe kërkoji t'i bëjë gjërat më të lehtë – më tha ai.

Pastaj unë shkova dhe kthehesha ndërmjet Zotit të madhëruar dhe Musait, derisa Ai tha:

- O Muhamed, ato janë pesë namaze ditë-natë, secili prej tyre ka vlerën e dhjetë namazeve, kështu që bëhen pesëdhjetë namaze...(E ka nxjerr Muslimi 162)

4. Numri i namazeve që janë detyrë është pesë

Ibën Kudameh ka thënë:

“Namazet e detyrueshme (*fard*) janë pesë në ditë-natë dhe nuk ka asnjë kundërshtim për detyrimin e tyre.”

Prej argumenteve që tregojnë se ato janë pesë: Fjala e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

(الصلوات الخمس والجمعة إلى الجمعة كفارة لما بينها إذا اجتنبت الكبائر)

“Pesë namazet dhe xhumaja deri në xhuma janë fshirje gjynahesh për ato që bëhen ndërmjet tyre, derisa nuk kryen mëkatet e mëdha.”²

Po ashtu fjala e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

أرأيتم لو أن نهراً بباب أحدكم يغتسل منه كل يوم خمس مرات هل يبقى من درنه شيء ؟ قالوا : لا ، قال : كذلك الصلوات الخمس يمحو الله بهن الخطايا)

“A keni parë sikur një lum të kalojë para derës së ndonjërit prej jush dhe ai të lahet në të çdo ditë pesë herë. A do të mbesë tek ai ndonjë gjë prej papastërtisë?”
Thanë (sahabët): "Jo!" Tha (profeti): “Po kështu është edhe puna me pesë namazet; Allahu largon me to gjynahet.” (Mutefekun alejhi)

5. Gjykimi për atë që lë namazin

Lënësi i namazit nuk del nga dy gjendje:

E para: Ta lërë ata (namazin) duke e mohuar obligimin e tij. Ky person është jobesimtar (kafir) me konsensus (*ixhmanë*). Ngase ai është përgënjeshtroi Allahun, i Cili ka thënë:

[وما أمروا إلا ليعبدوا الله مخلصين له الدين حنفاء ويقيموا الصلاة ويؤتوا الزكاة وذلك دين القيمة]

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), si dhe të falnin namazin e të jepnin zeqatin. Kjo është feja e drejtë.” (El Bejjine 5)

Gjithashtu, ai është përgënjeshtroi të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), i cili ka thënë:

(بني الإسلام على خمس شهادة أن لا إله إلا الله وأن محمداً رسول الله ، وإقام الصلاة ، وإيتاء الزكاة ، ...)

“Feja islame është ndërtuar mbi pesë (shtylla): Dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit...” (Mutefekun alejhi)

E dyta: Ta lëri namazin nga përtacia dhe neglizhenca. Në këtë rast, dijetarët kanë rënë në kundërshtim duke pasur dy qëndrime.

² E ka nxjerr imam Muslimi 1/209 me nr. 223

1. Fjala e parë: Ai është jobesimtarë (kafir). Ky është medh'hebi hanbeli. Po ashtu, këtë fjalë e ka thënë Seid bin Xhubejr, Esh Sheabi dhe Ibën el Mubarek.

Argumentet e tyre:³

Transmetohet nga Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(بين الرجل والشرك والكفر ترك الصلاة)

'Ndërmjet personit, shirkut dhe kufrit është lënia e namazit.'" (E transmeton imam Muslimi)

Transmetohet nga Burejdeh (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(العهد الذي بيننا وبينهم الصلاة فمن تركها فقد كفر)

"Marrëveshja ndërmjet nesh dhe tyre është namazi. Kushdo që e lë atë (namazin), ka mohuar."⁴

Transmeton Abdullah bin Shekik el Akili (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë:

(لم يكن أصحاب محمد يرون شيئاً من الأعمال تركه كفر غير الصلاة)

³ Allahu i Madhëruar thotë:

"Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshtet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh, përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në Xhenet dhe nuk do t'u bëhet kurrfarë padrejtësie..." (Merjem 59-60)

I Madhëruari thotë:

"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet, të cilët duan vetëm që të duken dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve." (El Maun 4-7)

"Çfarë ju ka sjellë në Sekar?" Ata do të përgjigjen: "Nuk ishim nga ata që falnin namaz..." (El Mudethir 42-43) (sh. p.)

⁴ E ka nxjerr Ahmedi në "Musned" 5/346 dhe 355, Et Tirmidhiu në kapitullin "El Ijman", tema "Çfarë ka ardhur për lënien e namazit", hadithi me nr. 2623; En Nesaiu në "El Muxhtebe" 1/231; Ed Darakutni në "Es Sunen" 2/52; Ibën Hibani 1454; Ibën Maxheh në "Es Sunen" me nr. 1079; Ibën Ebi Shejbe në "El Ijman" me nr. 46 dhe në "El Musanef" 11/34; Hakimi në "El Mustedrak" 1/6-7, e ka saktësuar dhe e ka aprovuar Dhehebiu etj. Hadithin, gjithashtu, e ka saktësuar dhe Et Tirmidhiu dhe Ibën Hibani. Ai është sipas kushtit të Muslimit, siç ka thënë Ibnul Kajjim në librin e tij "Namazi dhe gjykimi për lënësin e tij," fq. 46.

“Ishin shokët e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) që nuk shihnin ndonjë punë lënia e së cilës ishte kufër përveç namazit (lënies së tij).” (E transmeton Et Tirmidhiu)

2. Fjala e dytë: Ai nuk është jobesimtar. Këtë fjalë e ka thënë hanefitë, malikitë, dhe Nevaviu ia ka adresuar këtë shumicës së selefëve dhe khalefëve (të mëvonshmëve).

Argumentet e tyre:

Hadithi i Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ku tha: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

(أسعد الناس بشفاعتي يوم القيامة من قال لا إله إلا الله خالصاً من قلبه)

“Njeriu më i lumtur për ndërmjetësimin tim ditën e Kiametit është ai, që thotë la ilahe il lAllah/nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, me sinqeritet, nga zemra e tij.” (E transmeton imam Buhariu)

Po ashtu, fjala e tij (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

(من مات وهو يعلم أنه لا إله إلا الله دخل الجنة)

“Kushdo që vdes dhe ai e di se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, ka për t’u futur në xhenet.” (E transmeton imam Muslimi)

Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e ka bërë të qartë se kushdo që thotë la ilahe il lAllah/nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, meriton që të futet në xhenet.

Allahu i Madhëruar thotë:

[إن الله لا يغفر أن يشرك به ويغفر ما دون ذلك لمن يشاء]

“Vërtet, Allahu nuk fal që t’i bëhet shok Atij⁵, kurse të tjerat përveç kësaj, ia fal kujt të dojë⁶...” (En Nisa 48)

⁵ Duke adhuruar apo krahasuar diçka apo dikë prej krijesave të Allahut bashkë me Allahun apo në vend të Tij.

⁶ Gjynahet e tjera përveç shirkut (shok-vënies Allahut në adhurim, hyjnizim dhe attribute) dhe kufrit (mohimit të Allahut apo të diçkaje të ardhur nga Ai), qofshin ato gjynahe të vogla apo të mëdha, Allahu ia fal kujt të dojë, me shkaqet e ndryshme të faljes si: veprat e mira që fshijnë të këqijat, fatkeqësitë që i vijnë besimtarit në dynja, duaaja e besimtarëve për njëri-tjetrin, dhe mbi të gjitha këto, mëshira e Tij të cilën e

*(**Sipas autorit**) Fjala më e saktë është fjala e parë; se ai (lënësi i namazit) është jobesimtar (kafir).⁷

Shejh Uthejmini (Allahu e mëshiroftë!) thotë:

"Nëse të bëhet e qartë se lënësi i namazit është kafir - kufër që të nxjerrë prej popullit mysliman -, atëherë mbi të gjykohet me dispozitat e *murtedevë* (ata që dalin prej islamit). Prej tyre:

- 1) Martesa e tij nuk është e saktë. Nëse ai lidh kurorë dhe nuk falet, atëherë martesa është *batil* (e kotë e pavlefshme).
- 2) Nëse ai ther, e therura e tij nuk hahet.
- 3) Ai nuk trashëgon dhe as nuk trashëgohet.
- 4) Kur të vdesë, ai nuk lahet, nuk qefinohet, nuk i falet namazi dhe nuk varroset me myslimanët (në varrezat e tyre).
- 5) Ai, ditën e Kiametit, do të ringjallet me faraonin, Hamanin, Karunin dhe Ebi bin Khalef".

Dobi: Kur quhet lënësi i namazit jobesimtarë (kafir)?

Kanë thënë: Ai bëhet jobesimtar, nëse lë një namaz farz të vetëm.

Po ashtu kanë thënë: Ai bëhet jobesimtar (kafir) me lënien e dy namazeve farz.

Shejh Uthejmini (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Ajo e cila bëhet e qartë nga argumentet, është se ai nuk bëhet jobesimtar vetëm nëse i lë gjithmonë namazet, d.m.th. e ka vendosur (ia ka bërë detyrë vetes) që të lërë namazin. Nuk e fal namazin e drekës, as namazin e ikindisë, as namazin e akshamit, as namazin e jacisë dhe as namazin e sabahut. Ky është ai i cili bëhet jobesimtar. Nëse ai është që fal ndonjë namaz farz apo dy, ai nuk bëhet jobesimtar."

{Mësimi i tretë}

Hadithi nr. 2

meritojnë më së shumti besimtarët dhe njësuesit e Tij. Ndryshe nga idhujtari, i cili ia ka mbyllur vetes dyert e mëshirës dhe atij nuk i bëjnë dobi punët e tjera të mira përderisa i bën Allahut shok, sepse Allahu nuk fal asnjë gjynah të shoqëruar me shirk, apo nga ai që bën shirk.

⁷ Për më shumë shih librin "Lënësi i namazit" të shejh Albanit (Allahu e mëshiroftë!), ku tregohet se kjo nuk është fjala më e saktë. Allahu e di më së miri! (Sh.p.)

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ-رضي الله عنه- قَالَ : قَالَ رَسُولُ اللَّهِ: ((لَا يَقْبَلُ اللَّهُ صَلَاةَ أَحَدِكُمْ إِذَا أَحْدَثَ حَتَّى يَتَوَضَّأَ))

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Allahu nuk e pranon namazin e askujt prej jush pas *hadethit* (jashtëqitjes dhe çdo gjëje që prish abdesin), veçse pasi ai të marrë abdes."⁸

Transmetuesi i hadithit:

Ai është Abdurrahman bin Sakhra ed Duvejsi. E ka pranuar Islamin në vitin e Hajberit (në vitin e shtatë të hixhretit). Shkaku i emërimit të tij me kunjën Ebu Hurejra, është se ai, kur ishte i vogël, kishte një kotele (mace e dobët) të vogël, me të cilën lozte. Ai është një prej sahabëve që ka transmetuar më shumë hadithe, gjithsej 5374 hadithe. Ka vdekur në vitin 57 të hixhretit.

Kuptimi i fjalëve:

Me "... nuk e pranon ..." është për qëllim mohimi i vlefshmërisë (së namazit).

"... namazin..." ka ardhur në formë të panjohur dhe është për qëllim të gjitha namazet; namazi kur je vendas, namazi në udhëtim dhe namazi i xhenazes.

"... pas hadethit..." , kur del prej personin çdo gjë që e prish abdesin, siç është urina, nevoja dhe gazrat.

Dobitë që përfitohen nga hadithit:

1. Ky hadith është argument për marrjen e abdesit dhe se ai është kusht për vlefshmërinë e namazit.

Neveviu (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

"Ky hadith është argument për obligimin e pastërtisë për namaz. Populli ka rënë në konsensus se pastërtia është kusht për vlefshmërinë e namazit."

Gjithashtu, ai (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

⁸ E transmeton Buhariu 2954, Muslimi 225, Tirmidhiu 76 dhe Ebu Daudi 60.

“Populli ka rënë në konsensus për ndalimin e të falurit pa pasur abdes, qoftë prej ujit apo dheut. E nuk ka dallim në të ndërmjet namazit *fard* dhe atij të vullnetsëm (*nafile*).”

2. Hadithi argumenton se namazi i falur pa abdes, është *batil* (i kotë, i pavlefshëm), qoftë ajo (gjërat që e prishin abdesin) me dëshirën e personit, apo jo.

3. Kushdo që e fal namazin me vetëdije duke mos pasur abdes dhe pa arsye, ai është gjynahqar. Por, a është ai jobesimtar?

Kanë thënë: Ai nuk bëhet jobesimtarë. Nevaviu ia ka adresuar këtë fjalë xhumhurve.

Kanë thënë: Ai është jobesimtar. Nevaviu ia ka adresuar këtë fjalë Ebu Hanifes.

4. Kushdo që e prish abdesin gjatë kohës që është duke falur, nuk i lejohet atij që ta plotësojë namazin, porse e ka detyrë që ta ndërpresë ata. Nëse ai e plotëson namazin duke qenë në atë gjendje, ai është gjynahqar.

5. Nëse imami e prish abdesin, atëherë ai e ka detyrë të dalë prej namazit dhe nuk i lejohet atij që ta plotësojë atë. Porse njëri prej xhematit del para në vend të tij për të plotësuar namazin me namazlinjtë.

Dijetarët janë në kundërshtim në lidhje me sexhden e falënderimit dhe sexhden kur lexojmë Kuran se a duhet patjetër që personi të ketë abdes, apo jo?

Kanë thënë: Patjetër që duhet të ketë abdes. Ky është medh’hebi (hanbeli), ngase ajo është namaz.

Kanë thënë: Nuk është pastërtia kusht për kryerjen e tyre. Kjo është edhe zgjedhja e Shejhul islam Ibën Tejmije, Ibën Kajimit dhe Sheukanit.

Nuk është transmetuar nga Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se ai është pastruar (ka marrë abdes) për kryerjen e sexhdes së leximit si dhe nuk është transmetuar se ai ka urdhëruar për këtë gjë. Gjithashtu, ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka bërë sexhde kur ka lexuar suren “Nexhm” dhe bashkë me të kanë bërë sexhde edhe muslimanët dhe mushrikët, dhe nuk na është transmetuar se ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi për abdes ndonjë prej muslimanëve që ndodheshin me të. Është transmetuar nga Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy

ata!) se ai binte në sexhde (sexhden e falënderimit dhe sexhden e leximit të Kuranit) duke mos qenë me abdes. Kjo është dhe fjala më e saktë.

6. Prej dobive që përfitohen nga ky hadith: nëse personi nuk gjen ujë ose dhë, atëherë ai falet sipas gjendjes së tij. Duke u bazuar në fjalën e Allahut të Madhëruar:

[فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ]

“Frikësojuni Allahut aq sa të keni mundësi.”

Si dhe në fjalën e të Dërguarit të Allahut (Pagja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!):

(إِذَا أَمَرْتُمْ بِأَمْرٍ فَأَتُوا مِنْهُ مَا اسْتَطَعْتُمْ)

“Kur t’ju urdhëroj për diçka, atëherë kryeni atë me sa të mundeni.” (Mutefekun alejhi)

E ka zgjedhur këtë fjalë Nevaviu dhe ka thënë:

“Kjo është prej fjalëve më të forta.”

Po ashtu, e ka zgjedhur këtë shejhul islam Ibën Tejmije.

Kanë thënë: Është detyrë që ai të falet në gjendjen që ndodhet e më pas ta përsërisë namazin.

Kanë thënë: E ka të ndaluar të falet dhe e ka detyrë të falet *kada* (ta kompensojë).

7. Kush falet e, pas një kohe, kujtohet se e ka falur namazin duke mos pasur abdes, ai e ka detyrë ta përsërisë namazin.

{Mësimi i katërt}

Hadithi nr. 3

عَنْ عَبْدِ اللَّهِ بْنِ عَمْرٍو بْنِ الْعَاصِ وَأَبِي هُرَيْرَةَ وَعَائِشَةَ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ قَالُوا : قَالَ رَسُولُ اللَّهِ :
(وَيَلِّ لِلْأَعْقَابِ مِنَ النَّارِ)).

Transmetohet nga Abdullah bin Amër bin el Asi, si dhe nga Ebu Hurejra dhe Aisha (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) se kanë thënë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Mjerë për thembrat e këmbëve nga zjarri!"⁹

Vazhdon...

⁹ E ka nxjerrë Buhbariu 163 dhe 165, Muslimi 241, 242 dhe 240, Ahmedi 9/24570 dhe En Nesai 1/77-78.